



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PËR SULMIN NDAJ ANËTARIT TË OMK-së

18 tetor 2021
Prishtinë

Oda e Mjekëve të Kosovës me shqetësim, indignatë dhe zhgënjim ka pranuar njoftimin për sulmin ndaj kolegut A. TH. Nga Prishtina i cili u sulmua më datë 11 tetor 2021 në hapësirat e vendit të punës duke ofruar shërbimin shëndetësor, nga familjarët e pacientes. Sulmi ndaj mjekëve është bërë pjesë e protokollit të sjelljes së shërbimmarrësve nëpër institucione shëndetësore, ndërkaj mjeku është bërë viktimë e përhershme e këtyre sulmeve serike të cilat nuk kanë të ndalur.

Sulmet fizike e verbale ndaj personelit shëndetësor nuk kanë të ndalur as gjatë kësaj kohe pandemie, të cilët në vendin e punës pa asnjë mbrojtje dhe asnjë kujdes të veçantë, janë duke iu ekspozuar veprimeve vandale dhe të dhunshme të shërbimmarrësve, përkatësisht pacientëve dhe familjarëve të tyre. Ndërkaj, shqetësues mbetet fakti që institucionet përgjegjëse, sidomos ato të ndjekjes penale, me pasivitetin e tyre janë duke i stimuluar këto sulme që tanimë janë bërë fenomen ditor.

Tani e disa herë, Oda e Mjekëve të Kosovës ka përsëritur kërkesën që sulmet e tilla ndaj mjekëve që

ndërlidhen me veprimtarinë profesionale të tyre, të trajtohen në kuptim të sanksionimit penal në kuadër të sulmit ndaj personit zyrtar dhe që këto raste duhet të trajtohen me prioritet. Po ashtu, Prokuroria e Shtetit dhe Gjykatat duhet të vihen në veprim, sidomos në fazën e procedurës paraprake, në mënyrë që kryesve të këtyre veprave penale tu caktohet masa e paraburgimit, duke marrë parasysh probabilitetin që vepra e tillë mund të jetë e përsëritur ndaj mjekut i cili i është ekspozuar veprimit të tillë kriminal. Nuk ka asnjë dyshim që mjekët, si persona që janë të legjitimuar me leje të veçantë të punës për të ofruar shërbime shëndetësore, legjitimim ky i bërë nën kompetencën publike, në kuptim të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës janë persona zyrtar dhe si të tillë duhet të gëzojnë mbrojtje juridike nga cilido cënim i integritetit personal

dhe profesional, në veçanti kur kemi të bëjmë me sulmet gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe në vendin e punës.

Po ashtu, Oda e Mjekëve të Kosovës kërkon nga institucionet shëndetësore, autoritetet kompetente të nivelit qendror dhe atij lokal, që të trajtojnë me seriozitetin më të madh sigurinë në vendin e punës, pasi që mundësia e ekspozimit ndaj kriminalitetit të dhunshëm ndaj mjekut është e madhe. Trendi i deritanishëm e ka bërë që në kuadër të vlerësimit të rrezikshmërisë në vendin e punës të përfshihet edhe rreziku objektiv i cënimit të integritetit trupor të mjekut në vendin e punës.

Oda e Mjekëve të Kosovës do të përdorë të gjitha mjetet institucionale për të bashkëpunuar me akterët të tjerë shtetëror në mënyrë që të ndikojë në parandalimin e viktimizimit të mjekëve në shoqëri, si dhe të krijohen kushtet bazë të sigurisë në vendin e punës për të gjithë mjekët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.

Ne jemi aty ku Ju nuk dëshironi të jeni!

Me solidaritet,

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci

